



## KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI – SUHAREKË

Nr. Protokollit	01/ 2024
Vendi i takimit:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Datë:	13.02.2024

### PROCESVERBAL

Nga takimi i Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive “KKSB” - Suharekë të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Nr-27/2012, dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr-03/2012, për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Takimi filloi në ora 10.00

#### Në takim morën pjesë :

**Afrim Sylaj** - Komandant në Stacionin Policor në Therandë  
**Halim Shehu** - përfaqësues i Komunitetit Islam  
**Albert Demaj** - përfaqësues i Komunitetit Katolik  
**Enver Shabani** - Drejtoria e shërbimeve publike, siguri dhe emergjencë  
**Fetije Bytyqi** - përfaqësuese e EVSB-së  
**Remzi Bajselmani** - Drejtor i Drejtorisë së arsimit  
**Habibe Bytyqi** - Zyrtare për barazi gjinore  
**Albestrim Rexhepi** - përfaqësues i FSK-së  
**Drilon Zyba** - përfaqësues i KLSP-së  
**Adem Derguti** - Kryetar i KPAK-së  
**Rozeta Jahaj** - përfaqësuese e OJQ-ë  
**Refki Zogaj** – përfaqësues i komunitetit të biznesit  
**Eurolinda Zenelaj** - përfaqësuese e medieve lokale  
**Xheladin Sadikaj** - përfaqësues i zyrës KKK-së  
**Qëndresa Baftjaraj** - përfaqësuese e KPAK-së  
**Myrvete Shala** - përfaqësuese e Shqiptarëve  
**Denis Sofra** - Kryesues i KK-së dhe përfaqësues i KA-li  
**Zekë Berisha** - përfaqësues i Romëve  
**Nazim Shabanaj** - përfaqësues i Egjiptasve

Mbledhjen e hapi Nënkyetarja e Komunës znj. Mihrije Suka e cila i njoftoi me rendin e ditës.

### **Rend dit**

- 1. Miratimi Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Analizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Suharekës;**
- 3. Identifikimi dhe krijimi i zonave të gjelbëruara përreth shkollave për të ruajtur hapësirën dhe sigurinë e plotë të nxënësve;**
- 4. Informatë dhe diskutim për projektet të infrastrukturës dhe të shërbimeve që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve;**
- 5. Trajtimi i qenve endacak;**

Nënkyetarja - e hedh në votim rendin e ditës.

**Aprovohet rendi i ditës**

**Pika 1. Miratimi procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

Nënkyetarja- e hedh në votim pikën 1.

**Aprovohet Pika 1**

**Pika 2. Analizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Suharekës;**

**Vehbi Bytyqi- shef i sektorit të krimeve në territor të Suharekës** - numri i vjedhjeve është i njëjtë sikur vitin e kaluar. Në dhjetor kanë qenë 5 vjedhje, në janar 10 vjedhje dhe në shkurt deri tani i kemi 2 vjedhje. Prej 17 vjedhjeve policia deri tani i ka zbulu 6. Në aspektin e sigurisë situata në komunë është e qetë dhe stabile.

**Nënkyetarja** - ne vazhdimisht kemi takime dy javore me policinë, LMT-në dhe OSCE-në dhe vazhdimisht raportojnë për të gjitha ndodhitë të cilat ndodhin. Nënkyetarja hap diskutimin.

**Drilon Zyba** - çka ka bë konkretisht komuna në parandalim? A mund të japim një propozim për funksionalizimin e kamerave nëpër fshatra. Kam fillu ta bë një pilot projekt për përgjegjësinë e fshatrave që jam i thirrur për këtë takim. A mundemi propozimin me dërgu te komuna apo te policia? Kush e merr përgjegjësinë e serverit?

**Nënkyetarja** - është një pyetje me vend dhe një prej instrumenteve kryesore për siguri janë edhe kamerat. Komuna ka punu në këtë aspekt ku ne kemi kamera në hyrje dhe dalje të Suharekës dhe pse mos ti kemi edhe nëpër fshatra. Serveri i kamerave është kompetencë e policisë dhe komuna nuk ka qasje. Komuna e realizon vendosjen e kamerave përmes projekteve të saj. Është i mirëseardhur projekti yt dhe mund ta adresosh te komuna.

**Avni Bytyqi** - nuk e ka parapa ligdhënësi rastësisht çështjen e përbërjes së KKSB-së. Prej se është themeluar KKSB kemi pas pika në rend dite që të vijnë projekte konkrete rreth çështjes së sigurisë, sikur në këtë rast që është kërkesa apo projekti yt. Ne disa herë përmes këtij këshilli kemi bë thirrje përmes OJQ-ve dhe njerëzve kompetentë që janë këtu, që të sjellin projekte konkrete që Komuna është e gatshme që ti realizon ato projekte nëse janë në të mirë të qytetarëve për çështjen e sigurisë. Kërkesa jote është me vend dhe sa i përket pyetjes tënde Komuna çdo herë është e gatshme të bëj për çështje të sigurisë atëherë kur vinë kërkesat konkrete apo projekte nga arterët kryesor që merren me çështjen e sigurisë. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

**Albestrim Rexhepaj** - çështja e kamerave do ti ndihmojë edhe policisë në aspektin e sigurisë, sidomos te udhëkryqi i Budakovës, rruga për Ferizaj është pikë kyqe te rastet e vjedhjes. Pas vendosjes së kamerave në qytet, për 50 % ka ramje te rastet e vjedhjeve në qytet.

**Drilon Zyba** - pikërisht për këtë po mundohem me bart edhe këtë rënie e 50% në fshatra sepse kanë ndërlidhje fshati me fshat dhe ikja po bëhet më e lehtë nëpër fshatra.

**Avni Bytyqi** - të gjitha temat që janë në rend dite kanë të bëjnë me çështjen e sigurisë dhe në fund do të dalim me rekomandime. Kush do që i sjell ato projekte konkrete për çështjen e sigurisë, kemi me i analizuar si ekzekutiv dhe besoj që kemi m'i jetësuar për arsye se jemi në fazën kur komuna pas një muaji fillon procesin e planifikimit të buxhetit për vitin 2025.

**Nënkryetarja** - sa për informacion, ne vazhdimisht kemi punu në vendosjen e kamerave. Nëkryetaja tutje jep sqarime rreth çështjes së kamerave të sigurisë.

**Rekomandim 1:** çdo herë të vazhdojë bashkëpunimi mes policisë dhe komunitetit dhe institucioneve tjera përgjegjëse.

**Rekomandim 2:** projektet që dorëzohen nga anëtarët e KKS-së e që ndërlidhen me çështjen e sigurisë, komuna ti merr parasysh dhe ti realizoj.

**Nënkryetarja** - i hedh në votim rekomandimet.

### Aprovohen rekomandimet

### **Pika 3. Identifikimi dhe krijimi i zonave të gjelbëruara përreth shkollave për të ruajtur hapësirën dhe sigurinë e plotë të nxënësve;**

**Nënkryetarja** - kjo pikë e rendit të ditës po përsëritet nga viti në vit dhe kjo me qëllim që të marrim projekte nga anëtarët e KKS-së, nga OJQ-të por pse jo edhe nga shoqëria civile, për hapësirat e gjelbëruara përreth shkollave. Komuna ka punu shumë rreth krijimit të ambienteve të mira dhe të gjelbëruara nëpër shkolla. Hap debatin për këtë pikë.

**Avni Bytyqi** - zyrtari ligjor jep sqarime dhe thotë që jo të gjitha projektet që planifikohen këtë vit do të barten për vitin 2025. Projektet që kanë vlera të mëdha financiare normal dojnë planifikim ndërsa projektet që kanë vlera që janë të përballeshme për komunën për vitin 2024 besoj që kanë me u realizu shpejt.

**Agim Bylykbashi** - sa i përket kësaj pikë, nuk është e thënë që mundet me qenë një projekt vetëm përreth shkollave. Shumica e shkollave kanë ambiente të gjelbëruara dhe vetëm në rastet kur shkolla nuk ka ambient të mjaftueshëm, p.sh në Samadraxhë nuk mund ta bësh një projekt të veçantë rreth shkollës dhe ne jemi tu mendu që edhe në Samadraxhë me qenë një shkollë e re për zona të gjelbëruara. Komuna ka punuar shumë në këtë aspekt duke krijuar zona të gjelbëruara pothuaj në secilin fshat, duke krijuar edhe zona rekreative për fëmijë dhe prap ka hapësir për projekte të tilla.

**Eurolinda Zenelaj** - komuna e Suharekës a ka njerëz adekuatë ose a ka pas ndonjëherë njerëz adekuatë që kanë shku rreth shkollave ose hapësirave tjera gjelbëruese për me i pa p.sh. drunjtë, punën ose llojin e bimëve që rriten aty. Ne me kriju i krijojmë ndoshta por vje një moment që e kemi pa edhe në komunën e Prishtinës ku vitin e kaluar prej erërave të forta ka pas drunjë të vjetër sa që janë rrëzuar dhe si pasojë ka vdek një person. A kontrollohen drunjtë, sidomos ku janë nxënësit dhe a mundet me u realizu një gjë e tillë?

**Avni Bytyqi** - drunjtë të cilët janë të vjetër ne i kemi të futur në zonën e mbrojtur dhe të gjithë ata drunjë që janë në mbrojtje e kanë edhe mbishkrimin që janë në mbrojtje për shkak të vjetërsisë. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

**Adem Dërguti** - rëndësi të madhe ka ambienti në shkolla. Nuk duhet të varemi ne që nëpër shkolla vetëm komuna duhet me investu. Aty më tepër varet se sa kanë interesim shkollat me rregullu atë ambient.

**Nënkryetarja** - kam has vet me i vizitu shkollat dhe vërtetë shkollat e komunës tonë janë në gjendje të mirë sidomos në aspektin e gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së oborrit. Pak shkolla nuk kanë gjelbërim.

**Rekomandim:** presim projekte konkrete.

**Rozeta Jaha** - dua të jap një rekomandim pikërisht me tematikën që e lidhi Eurolinda për shkak se të gjitha investimet që i bëjmë në nëpër shkolla dhe në cilësinë e arsimit janë të mirëseardhura.

Kisha dashtë me rekomandua që pikërisht një person adekuatë me u marrë me këtë çështje sepse në shkollat tona ende ka raste kur fëmijët nxiten dhe janë të gatshëm me humb një orë mësimore për me u marrë me një çështje që ka të bëjë me natyrën, gjelbërimin. Është me rëndësi që individ të caktuar të mirren çoftë me hapësira të gjelbërta, çoftë me gjithçka të caktune ku nxënësit me mbajte orën mësimore aty ku e kanë vendin.

**Nënkryetarja** - i hedh në votim rekomandimet.

## Aprovohen rekomandimet

**Pika 4. Informatë dhe diskutim për projektet të infrastrukturës dhe të shërbimeve që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve;**

**Nënkryetarja** - kjo pikë ka të bëjë për projektet në vazhdimësi. Hap debatin për këtë pikë.

**Agim Bylykbashi** - komuna në vazhdimësi ka projekte të ndryshme si në qytet dhe në fshatra të cilat listohen në mirëqenien e qytetarit. Drejtori tutje jep informacione rreth projekteve dhe cek dy projekte që janë më të mëdhaja dhe thotë që ato projekte na ndikojnë vështirësi te qytetarët por ne duhet ta dimë që projektet e mëdhaja marrin kohën dhe hasin vështirësi.

**Habibe Bytyqi** - realisht propozimet që do të bëjë unë nuk do të thotë që nuk i ka bë deri tani komuna. Propozoj që të zgjerohet rrjeti i ndriçimit për shkak se pasja e ndriçimit është më shumë siguri për gratë,po ashtu një kujdes të veçantë për projektet kapitale infrastrukturore që do t'i ketë komuna. I propozoj drejtorit që të ketë kujdes shumë të çështja e pjerrinave sidomos në rrugë për shkak se edhe nëpër qytet ka vështirësi për personat me aftësi të kufizuara dhe për nanat që kanë fëmijë në karroca. Propozimi tjetër shkon për drejtorinë e shëndetësisë për shkak se gjinekologjia ka kalu në katin e dytë dhe vërtetë qasja nuk është e duhur.

**Nënkryetarja** - vazhdimi unë dhe ti punojmë sidomos për çështjen gjinore dhe falë projekteve tona dhe grupit të grave asamblistë ne e kemi fut si pikë kryesor ndriçimin për sigurinë e grave kur ishte buxhetimi gjinor dhe thuaj në të gjithë fshatrat ka ndriçim. Te çështja e gjinekologjisë që e cila ka kalu në katin e dytë,nuk ka qenë një ide e mirë. QKMF-ja nuk ka lift dhe ne e kemi si ide që të bëhet një lift. Sa i përket pjerrinave dhe qasjeve për persona me aftësi të kufizuara,përpos objekteve të vjetra siq është komuna dhe disa objekte tjera që nuk kanë mundësi të bëjnë lifta, gjimnazi e ka bë një zgjidhje. Ne vazhdimisht jemi në kërkim të zgjidhjeve për të gjithë qytetarët pa dallim.

**Agim Bylykbashi** - e kuptoj Habiben. Kemi institucione publike që vërtetë nuk kanë qasje për persona me aftësi të kufizuara por ne duhet të mendojmë dhe jemi duke bërë projekte të ndryshme që ti krijojmë qasje sa më të lehtë.

**Nënkryetarja** - dua të ju njoftoj që komuna ka bërë qendrën për të gjitha shërbimet në një vend dhe së shpejti funksionalizohet.

**Avni Bytyqi** - Vërtetë si objekt nuk e kanë qasjen por qasjen qytetarët e kanë çdo herë për arsye Kryetari i komunës në disa raste ka dal dhe e ka taku qytetarin me nevoja të veçanta dhe i ka marrë shqetësimet e tyre dhe çdo zyrtar që e ka për obligim ti ofroj shërbime qytetarëve,çdo herë kur ka nevojë dalin te qytetari me nevoja të veçanta dhe i realizojnë qëllimet dhe kërkesën e tyre.

**Drilon Zyba** - nuk është problemi vetëm te objektet e vjetra por ne e kemi problemin që po ndërtohen projekte të reja dhe po ndërtohen rrugë e trotuareve nuk po i lihet vendi për personat me nevoja të veçanta. Ju po thoni që në komunë i bëni zgjidhje por problemi është që ai s'ka qasje ndoshta as me hy në oborrin e komunës.

**Avni Bytyqi** - në katin e parë kanë qasje të gjithë qytetarët pa dallim.

**Nënkryetarja** - sa i përket qasjes ka qasje në katin e parë por këto janë mundësitë për shkak të vjetërsisë së objektit. Unë veq e ceka që është bë objekti për shërbime nga secila drejtori.

**Drilon Zyba** - u pajtova me ndërtimet e vjetra por momentalisht më kujtohet trotuari afër shkollës së Mushtishtit ku nuk ka qasje për persona me nevoja të veçanta.

**Avni Bytyqi** - Të lutem adresojë një kërkesë te Drejtoria e Shërbimeve Publike sepse është çështje që e kemi obligim ligjor që ti krijojmë kushte në çështjen e infrastrukturës personave me nevoja të veçanta dhe do ta rregullojnë. Unë e thash dhe në fillim që të gjithë arterët kryesor janë të involvuar në KKSB me qëllim që ti jepni shqetësimet rreth çështjes së sigurisë pa dallim.

**Drilon Zyba** - unë propozoj që asnjë trotuar në komunën e Suharekës mos të bëhet projekti i atij trotuari pa hy qasja për personat me nevoja të veçanta.

**Rekomandim:** Të gjitha projektet të bëhen sipas standardeve për persona me nevoja të veçanta.

**Rekomandim:** Drejtoria e Inspeksionit në bashkëpunim me policinë ti lirojnë hapësirat publike për lëvizjen e lirë të qytetarëve për shkak të investimeve që po bëhen në qytet.

**Nënkryetarja** - i hedhë në votim rekomandimet.

## Aprovohen rekomandimet

### Pika 5. Trajtimi i qenve endacak;

**Nënkryetarja** - kjo pikë është vërtetë shqetësuese jo vetëm për komunën tonë por në gjithë Kosovën. Hap debatin dhe ia jep fjalën Drejtorit të Bujqësisë.

**Ardian Kotorri** - ashtu siç potencoi nënkryetarja problemi i qenve endacak është problem madhor në gjithë Kosovën. Ne si komunë vazhdimisht kemi bërë përpjekje për të bërë zgjidhje optimale apo të qëndrueshme por është një problem i cili është vështirë për tu zgjidhur. E kemi një procedurë tenderuese ku çdo vit planifikojmë buxhet për trajtimin e këtyre qenve endacak ato të cilat janë parapa me ligj në bazë të rregulloreve të agjencive të ushqimit. Drejtori tutje jep sqarime sa i përket problemit për trajtimin e qenve endacak.

**Eurolinda Zenelaj** - me sa e mbaj mend në një mbledhje të KKSB-së e kemi diskutuar një projekt që e ka prezantua një vajzë nga Mushtishti e cila jeton jashtë, ku i ka kërkuar Komunës së Suharekës për me i ndihmu për me i strehua qentë endacak dhe me i trajtuar aty. Këtë e ka diskutu edhe Kryetari. Ku ka arrit ky projekt? A e ka marrë parasysh Komuna dhe nëse ka ngecje amund ta dimë pse ka ngecje?

**Ardian Kotorri** - bashkë me Kryetarin jemi në kontakt me atë që bisedove dhe jo vetëm me atë por edhe me OJQ të ndryshme. Për momentin nuk kemi ndonjë epilog në atë drejtim por megjithatë do ta kemi një përkrahje prej qeverisë besoj sepse është shumë e kushtueshme.

**Brahim Thaqi** - na është prezentu si ide e mirë për me marr një lokacion por jo projekt konkret. Është një kosto shumë e madhe dhe s'mund të përballohet. Unë kam bisedu me zëdhënës ministrin e MAPL-së dhe po presim me ardhë ata dhe me gjet bashkë një zgjidhje.

**Albestrim Regjepaj** - dua të ju informoj që FSK-ja i ka mbajtur disa ligjërata vetëdijesuese ndaj mjeteve të pashpërthyer pothuaj nëpër secilën shkollë në nivel qendror dhe Suhareka ka qenë e përfshirë në këtë kampanjë. Ligjëratat janë mbajtur në shkollën "Abdyl Ramaj".

**Avni Bytyqi** - në kuadër të planit të punës së KKSB-së e kemi të paraparë pikën për trajtimin e mjeteve të pashpërthyer të luftës me qëllim që komuna apo Drejtoria e Arsimit të bëjë kërkesë në Ministrinë e Mbrojtjes që të vinë dhe të mbajnë trajnime njerëz të cilët janë të licencuar për këto çështje dhe ti vetëdijësojmë qytetarët por më së shumti nxënësit.

**Albestrim Regjepaj** - në FSK ekziston ekipi i specializuar për tërheqjen dhe demolimin e mjeteve të pa shpërthyer.

Takimi përfundoi: 11:15

Procesmbajtësja:  
Dafina Haziraj